REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATURA E SHTETIT
ZYRA E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM

Nr.7284/4 Prot. Tiranë, më 05.10.2026

Lënda: Kthim përgjigje lidhur me "Njoftimin Formal për Mosmarrëveshje Investimi dhe Kërkesën për Zgjidhje Miqësore për projektin 'Europort Shëngjin – Shqiponja e Adriatikut"

Drejtuar: Z. Lirim MUHAREMI

Në adresën elektronike:
lirim.muharemi@oneworldorder.eu

I nderuar Z. Muharemi,

Në vijim të email-it tuaj me objekt "Njoftimit Formal për Mosmarrëveshje Investimi dhe Kërkesën për Zgjidhje Miqësore", i regjistruar pranë institucionit tonë me nr. 7284 prot., datë 02.09.2026, lidhur me projektin "Europort Shëngjin – Shqiponja e Adriatikut", Avokatura e Shtetit, në cilësinë e institucionit që përfaqëson Republikën e Shqipërisë, ju përcjell sa vijon:

Për shqyrtimin e pretendimeve të parashtruara nga ana juaj, Avokatura e Shtetit, me shkresën nr. 7284/2 prot., datë 11.09.2026, i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), duke kërkuar verifikimin dhe përcjelljen e dokumentacionit institucional që lidhet me projektin dhe çështjet e ngritura në Njoftimin tuaj.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga MIE, rezulton se në arkivin e Ministrisë është identifikuar dokumentacion që lidhet me projektin e propozuar për ndërtimin dhe shfrytëzimin e një porti në Shëngjin. Sipas dokumentacionit të vitit 2008 të përcjellë, është konfirmuar vullneti i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për nxitjen e investimeve në vend dhe është sqaruar se shprehja e interesit të subjektit ishte trajtuar në përputhje me nenin 23 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006, "Për koncesionet", të ndryshuar. Konkretisht, është identifikuar shkresa e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit nr. 4167/1 prot., datë 06.11.2008, me

lëndë "Kthim përgjigje", drejtuar subjektit "Lirim Muharemi & Comp." lidhur me propozimin për ndërtimin dhe shfrytëzimin e një porti në Shëngjin.

Nga përmbajtja e kësaj shkrese rezulton se Ministria i është përgjigjur kërkesës së paraqitur në lidhje me propozimin për ndërtimin dhe shfrytëzimin e një porti në Shëngjin, duke sqaruar, ndër të tjera, se projekt-idea ishte konsideruar me interes publik paraprak, ndërsa subjektit i kërkohej paraqitja e të dhënave dhe dokumentacionit të nevojshëm për vijimin e shqyrtimit të projektit të propozuar. Në këtë kuadër, Ministria, në cilësinë e autoritetit kontraktues, shprehej se ishte e autorizuar të shqyrtonte dhe të pranonte propozime të pakërkuara sipas procedurave të parashikuara në ligj, me kusht që ato të mos kishin të bënin me një projekt për të cilin kishte filluar ose ishte shpallur procedura e përzgjedhjes.

Krahas gatishmërisë për shqyrtimin e propozimit të pakërkuar sipas legjislacionit në fuqi në atë kohë, shkresa e Ministrit përcaktonte shprehimisht kufijtë dhe kushtet e këtij shqyrtimi, si më poshtë:

- Shprehja e interesit nuk nënkuptonte krijimin e ndonjë të drejte ekskluzive të subjektit mbi projektin dhe as nuk përbënte përfundim të procedurave administrative të mëtejshme lidhur me të;
- Asnjë institucion publik, i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, nuk kishte përgjegjësi për rimbursimin e shpenzimeve financiare që subjekti kërkues kryente gjatë kësaj procedure për përgatitjen e dokumentacionit;
- Shkresa sqaronte se, sipas ligjit, asnjë kontratë apo marrëveshje nuk mund të negociohej ose nënshkruhej me Ministrinë, përveç komunikimit zyrtar në adresat përkatëse, të përcjellë nëpërmjet postës, në përputhje me ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006, "Për koncesionet", të ndryshuar, dhe VKM-në nr. 27, datë 19.01.2007, "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve", të ndryshuar;
- Në atë fazë dhe gjatë gjithë procedurës së shqyrtimit të propozimit të pakërkuar, subjekti trajtohej si aplikant/propozues në kuadër të procedurës për shqyrtimin e një propozimi koncesionar.

Në këtë kuadër, dokumentacioni i identifikuar nga MIE nuk konfirmon pretendimin se, në vijim të paraqitjes së projektit dhe dokumentacionit përkatës, është krijuar një e drejtë kontraktore, koncesionare apo e drejtë tjetër ekskluzive mbi projektin. Gjithashtu, MIE ka konfirmuar se, nga verifikimi i kryer, nuk rezulton të jetë administruar pranë saj dokumentacion tjetër shtesë lidhur me këtë projekt, përfshirë kontrata koncesioni, marrëveshje investimi, marrëveshje të tjera të natyrës kontraktore ose administrative që të krijojnë, në favorin tuaj, një të drejtë të fituar lidhur me projektin "Europort Shëngjin – Shqiponja e Adriatikut".

Për rrjedhojë, dokumentacioni institucional i identifikuar pasqyron trajtimin e një propozimi të pakërkuar dhe vlerësimin e interesit publik paraprak, të kushtëzuar nga plotësimi i dokumentacionit dhe ndjekja e procedurave përkatëse. Ai nuk dëshmon dhënien e një koncesioni, miratimin përfundimtar të projektit, njohjen e të drejtave ekskluzive apo marrjen përsipër nga institucionet publike të rimbursimit të shpenzimeve për përgatitjen e dokumentacionit.

Për shqyrtimin e pretendimeve tuaja lidhur me dorëzimin, pronësinë, riprodhimin, përshtatjen apo përfshirjen e materialeve të projektit tuaj në dokumente të mëvonshme shtetërore nga verifikimi i kryer deri në këtë fazë nuk rezulton të jetë identifikuar dokumentacion në arkivin e MIE-së që të provojë një përdorim të tillë nga ana e institucioneve shtetërore. Në këto kushte, nëse i qëndroni pretendimeve të tilla, ju kërkojmë të përcillni kopjet e dokumenteve provuese të referuara në Njoftim, të cilat nuk i janë bashkëlidhur atij, përfshirë provat e dorëzimit pranë autoriteteve shqiptare, aktet mbi të drejtat që pretendoni mbi këto materiale dhe dokumentet që, sipas jush, provojnë përdorimin e tyre pa autorizim.

Avokatura e Shtetit vëren gjithashtu se Njoftimi juaj e rezervon shprehimisht të drejtën për të plotësuar dhe specifikuar më tej pretendimet faktike dhe juridike, si dhe për të paraqitur dokumentacion shtesë. Për këtë arsye, Republika e Shqipërisë rezervon të gjitha të drejtat për të paraqitur argumente, prova dhe kundërshtime të mëtejshme, në varësi të çdo informacioni apo dokumentacioni shtesë që mund të paraqitet në vijim.

Kjo përgjigje nuk përbën njohje të pretendimeve të parashtruara në Njoftimin tuaj, të cilësisë së investitorit apo të ekzistencës së një investimi të mbrojtur sipas marrëveshjes dypalëshe të referuar prej jush, dhe as pranim të përgjegjësisë së Republikës së Shqipërisë. Republika e Shqipërisë rezervon të gjitha të drejtat dhe kundërshtimet e saj lidhur me juridiksionin, pranueshmërinë, zbatueshmërinë e marrëveshjes, kushtet procedurale, përgjegjësinë dhe dëmet.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

AVOKAT I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AVOKATURA E SHTETIT -